



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 218/2 prot.

Tiranë, më 16.04.2018

VENDIM

Nr.33, datë 16.04.2018

PËR

**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 239, DATË 26.12.2017, NË
INSTITUCIONIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT, PYJEVE
DHE UJËRAVE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 239, datë 26.12.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 1565/2 prot., datë 13.09.2017”, në institucionin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave,

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet shkresës nr. 1565 prot., datë 30.08.2017, drejtuar Komisionerit, nëpunësi *****, me detyrë Inspektor, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Dega Rajonale Vlorë, ka paraqitur pranë Komisionerit pretendimet e tij në lidhje me marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil”, nga Komisioni Disiplinor, në kundërshtim me ligjin.

Me aktin nr. 1565/3/2, datë 13.09.2017, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit”, Komisioneri kërkoi nga institucioni, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, të gjithë dokumentacionin që materializon këtë proces disiplinor. Në përfundim të hetimit administrativ, ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 239, datë 26.12.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 1565/2 prot., datë 13.09.2017”, në të cilin është vendosur:

*“1. Të kërkoj nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin, bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/20151, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 266, datë 14.08.2016, për dhënien e masës së pezullimit për nëpunësin *****”.*

*2. Të kërkoj nga Komisioni Disiplinor, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin, bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/20151, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 5, datë 28.08.2016, për dhënien e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil”, për nëpunësin *****”.*

*3. Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin e ndërprerjes së marrëdhënies financiare, bazuar në nenin 111, të ligjit nr. 44/20151, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të rregullojë pasojat, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 278, datë 04.09.2017, “Për ndërprerjen e marrëdhënies financiare”, për nëpunësin ***** dhe të rikthejë punonjësin në pozicionin e mëparshëm të punës.*

*4. Departamenti i Administratës Publike të fshijë nga dosja e personelit dhe regjistri Qendror i Personelit, masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, të dhënë ndaj nëpunësit ***** me Vendimin nr. 5, datë 28.08.2017, të Komisionit Disiplinor, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.”*

Me kalimin e afatit procedural të lënë për zbatimin e rekomandimeve të Vendimit Nr. 239, datë 26.12.2017, “Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 1565/2 prot., datë 13.09.2017”, të Komisionerit, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, me shkresën nr. 432 prot., datë 31.01.2018, “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 239, datë 26.12.2017 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka informuar Komisionerin për zbatimin e këtij vendimi, duke bashkëngjitur edhe praktikën shkresore që materializon zbatimin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur shkresës së sipërcituar, konstatoj se, në **zbatim të pikës 1 të vendimit** paralajmërues të Komisionerit, në të cilën është kërkuar nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, në cilësinë e organit që ka nxjerrë aktin të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 266, datë 14.08.2016, për dhënien e masës së pezullimit për nëpunësin ***** me Urdhrin Nr. 27, datë 23.01.2018, Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të këtij akti.

Po kështu, në zbatim të **pikës 2 të vendimit** të Komisionerit, në të cilën është kërkuar nga Komisioni i Disiplinës të konstatojë menjëherë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 5, datë 28.08.2016, për dhënien e masës disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”, për nëpunësin në fjalë, Komisioni Disiplinor i ngritur me Urdhrin Nr. 268, datë 16.08.2017, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave, me Vendimin Nr. 1, datë 23.01.2018, në pikën 1, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të sipërcituar.

Në **pikën 3 të vendimit** objekt verifikimi, i është kërkuar Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, të rregullojë pasojat, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nr. 278, datë 04.09.2017, “*Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare*”, për nëpunësin ***** dhe të rikthejë punonjësin në pozicionin e mëparshëm të punës. Në zbatim të këtij rekomandimi, Kryeinspektori, me Urdhrin Nr. 28, datë 23.01.2018, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të këtij akti dhe ka vendosur rikthimin e menjëhershëm të punonjësit në pozicionin e mëparshëm të punës, “*Inspektor*”, në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Dega Rajonale Vlorë, duke i paguar pagën mujore që nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në daljen e këtij urdhri.

Në zbatim të **pikës 4**, të Vendimit Nr. 239, datë 26.12.2017, nga komunikimi me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit rezulton se masa e marrë ndaj nëpunësit në fjalë është fshirë si nga dosja e personelit, ashtu edhe nga Regjistri Qendror i Personelit.

Sa më sipër, konkludoj se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në Vendimin Nr. 239, datë 26.12.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 1565/2 prot., datë 13.09.2017*”, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 239, datë 26.12.2017, “*Mbi përfundimin e procesit të verifikimit, filluar me Urdhrin nr. 1565/2 prot., datë 13.09.2017*”.

2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e subjektit të inspektuar Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 239, datë 26.12.2017.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha